

17-se

2. Informacioni

EM

Nr. 868 Prot.

Datë 18.04.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
LUSHNJË

Nr. Rregj. Them. 595 (31138-01916-89-2023)

Datë 14.04.2025

Data e regjistrimit 04.12.2023

SHPALLJE PUBLIKE PER Z. ARETI PRIFTI.

BASHKIA DELVINË

Ne Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, është duke u gjykuar çështja që i përket paleve:

PADITËS:

Arjan Mehmeti, i biri i Nuri dhe i Xhiko, dtl.26.12.1961, lindur dhe banues në lagjen Nr. 3 Sarandë. Rrugë "Studenti" pranë spitalit "Petro Nako" Sarandë. Tel; 0693180123.

TË PADITUR:

1. **Agjencia Shtetërore e Kadastrës Sarandë.**
2. **Areti Prifti** e bija e Thanas dhe Margarita, dtl.1972, lindur dhe banuese në fshatin Senice, Njesia Administrative Vergo, Bashkia Delvine

PERSON I TRETE:

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Gjyrokaster

OBJEKTI :

Detyrimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të fshijë nga regjistrimi hipotekor Kontraten e Shit blerjes nr.1007 rep, nr.381 ko, dt.18.01.2002 lidhur ndërmjet Bashkisë Sarandë në rolin e shitesit dhe Areti Prifti në atë të bleresit për parcelën nr.96, blloku nr.B/12, me sipërfaqe 488 m², për shkak të pavlefshmëris absolute (pavetëtesis) të Vendimit të Keshillit Bashkisë nr.1, datë 28.8.99.

BAZA LIGJORE :

Neni 31, 32 K.Pr.C, NENI 92 K.C, Ligji nr.44/2015 K.Pr.A, Ligji nr.49/2012 "për organizimin dhe funksionimin e gjykatave



administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrati ligji nr.7843, date 13.7.1994 "Per regjistrimin e pasurive te paluajtshme" i ndryshuar. Neni 280 K.Pr.C, Vendimi Unifikues Gjykates se Larte nr.5, viti 2012.

Bazuar ne nenin 131 - 133(e ne vijim) te K.Pr. Civile te njoftohet **pala e paditur znj. Areti Prifti** se ne datën **22.05.2025 ora 11:30**, do te zhvillohet seanca perгатitore për çështjen administrative të sipërcituar. Bashklidhur shkresa per saktësim objekti , shtim ndergjyqesie , akt ekspertimi.

Nje kopje e kesaj shpallje afishohet prane:

1. Gjykates Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë
2. Bashkia Delvinë
3. Banuese në : "Senicë", Nd.041, Vergo, Bashkia Delvinë
4. Njesia Administrative Vergo
5. Nje kopje i jepet Specialistit te IT me qellim publikimin ne faqen zyrtare
6. Nje kopje e kesaj shpallje te kthehet e konfirmuar sipas ligjit

Nr. _____ Prot

Data e marrjes _____

Vula

GJYQATAR
EDISON TATOSHAJ



REPUBLIKA E SHQIPERIE

AVOKATIA SARANDE

Sarande me 31.03.2025

K E R K E S E

KERKUES : Arjan Mehmeti, atesia Nuri, amesia Xhiko, dtl.26.12.1961, banues ne lagjen nr.3
Sarande

OBJEKTI : Kerkojme shtimin e objektit te padise

Kerkojme te thirret si e paditur ne kete gjykim Bashkia Sarande

BAZA LIGJORE : Neni 161, 185 K.Pr.C

GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARE LUSHNJE

Gjyqtari: Edison TATOSHAJ

Prane kesaj gjykate shqyrtohet ceshtja administrative me pal

Padites : Arjan Mehmeti

Paditur :1. ASHK Sarande

2.Areti prifti

Objekti : Detyrimi i ASHK Sarande te fshije nga regjistrimi hipotekor Kontraten e Shitblerjes nr.1007 rep, nr.381 kol,dt.18.01.2002 lidhur ndermjet Bashkise Sarande dhe Areti Prifti per parcelen nr.96, blloku,b/12 me siperfaqe 488 m2 per shkak te pavlefshmerise absolute(pavertetesise) te vendimit te Keshillit Bashkise nr.1, date 28.9.99.

Referuar faktit procesi gjendet ne seance pergatitore. Ne kete faze te gjykimit konstatojme se kerkime tona duhet te shtrihen edhe ndaj personave te tjere, per keto arsye kerkojme te thirret ne kete gjykim edhe Bashkia Sarande.

Per nje zgjidhje sa me te drejte dhe perfundimatre te ceshtjes, kerkojme gjithashtu pa ndryshuar shkakun ligjor te padise te shtojme objektin e saj si me poshte:

Detyrimin e Bashkise Sarande te lidh kontraten e shitblerjes me paditesin Arjan Mehmeti per parcelen nr.96, blloku B/12 me siperfaqe 236 m2 nr.1, date 28.9.1999, rikonfirmuar nepermjet vendimit te Keshillit Bashkiak Sarande nr.48, dt.25.9.2006

Faktin e mesiperm e vertetojme me dokumentat bashkengjitur padise.

Lutemi te pranoni kerkesen sipas objektit te saj.

KERKUES

Arjan MEHMETI

A handwritten signature in dark ink, appearing to be 'Arjan', with a horizontal line drawn through it.